



E premte, 20 maj 2016

NJOFTIM

Mbledhja e IV-t e Bordit të ZRRE

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në mbledhjen e mbajtur me 19 maj 2016, ka aprovuar tarifat e reja nxitëse (Feed-in) për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë solare fotovoltaike dhe të ujit dhe erës.

Bordi duke vlerësuar se deri më tani nuk ka pasur zhvillim të mjaftueshëm të projekteve të energjisë së ripërtëritshme sidomos nga burimet e erës, ka ardhur në përfundim që skema aktuale mbështetëse nuk është mjaft atraktive për tërheqjen e investitorëve dhe si e tillë duhet të rimodelohet, prandaj dhe ka iniciuar rishqyrtimin e saj.

Pas shqyrtimit Bordi ka vendosur që kohëzgjatja e Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë së erës të jetë 12 vite, nga 10 sa ishte më parë, dhe të ketë një çmim prej 85 €/MWh. Ndërsa për hidrocentrale të vogla me kapacitet të instaluar me të vogël ose baras me 10MW çmimi do të jetë 67.47€/MWh me një kohëzgjatje prej 10 vitesh, të marrëveshjes për blerje të energjisë.

Tarifat e reja nxitëse (Feed-in) të vendosura nga Bordi, vlejné për kapacitetet gjeneruese me pajisje të reja (me zero operim), ndërsa për panelet solare/fotovoltaike pajisjet duhet të jenë të riciklueshme.

Në mbledhjen e djeshme, Bordi gjithashtu ka marrë vendim që të aprovojë kërkesat për lëshimin e Licencave për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike, të ndërmarrjeve "PAN INTERTRADE" SH.P.K dhe "GSA ENERGJI" SH.P.K.

Gjithashtu Bordi ka shqyrtuar aplikacionin për Autorizim fillestar për ndërtim të gjeneratorit me ujë HC "Radoniqi" me kapacitet 0.43 MW, të ndërmarrjes "Fidani Water Energy" sh.p.k. dhe ka aprovuar kërkesën për shtyrje të afatit për Autorizim Preliminar të ndërmarrjes "KELKOS-Energy Peja" sh.p.k. Bordi gjithashtu ka shqyrtuar dhe aprovuar kërkesën për modifikim të Autorizimit Final për HC "Belaja" 9.2 MW në 8.06 MW, dhe për HC "Deçan" nga 8.4 MW në 9.8 MW, të ndërmarrjes "KELKOS-Energy" sh.p.k.

Procesi i shqyrtimit të tarifave nxitëse dhe të gjitha vendimet e djeshme të Bordit do të publikohen në faqen elektronike të ZRRE-së www.ero-ks.org.